
POSTIM ARKIVOR

Et’hem Haxhiademi (1902-1965)



SEKSIONI

Artistë, shkrimtarë

PERIUDHA

1947 - 1947

Et’hem Haxhiademi lindi në Elbasan më 8 mars 1902. Pasi përfundoi shkollën në Elbasan, kreu studimet e mesme në Leçe të Italisë dhe në Insbruk të Austrisë gjatë viteve 1919–1923. Në periudhën 1924–1928 vijoi studimet e larta në Berlin dhe Vjenë, ku u diplomua në shkencat politiko-juridike. Pas kthimit në Shqipëri, ushtroi funksione në administratën shtetërore, paralelisht me zhvillimin e veprimtarisë së tij letrare dhe krijuese. Njihet si themelues i tragjedisë shqiptare me veprat “Ulisi”, “Akili”, “Aleksandri”, “Pirrua”, “Skënderbeu”, “Diomedi” dhe “Abeli”. Me vendosjen e regjimit komunist, u arrestua me akuzën si armik i popullit dhe mbështetës i Ballit Kombëtar. U dënua me vdekje, dënim i cili iu zëvendësua me burgim të përjetshëm. Dënimin e vuajti në burgjet e Elbasanit dhe Gjirokastrës, për ta përfunduar në Burrel, ku dhe vdiq më 17 mars 1965. Gjatë 20 viteve të burgimit u mor me përkthime nga greqishtja e vjetër, latinishtja, gjermanishtja dhe turqishtja. Eshtrat e tij ende nuk janë gjetur.


Seksioni 1

Dosja nr. 1565-A përmban dokumentacion procedural lidhur me procesin penal ndaj Et’hem Haxhiademi. Në të përfshihet letra e ndalimit e lëshuar në Elbasan më 07.01.1947, me motivacionin “armik i popullit”, si dhe urdhëresa e paraburgimit e datës 09.12.1947. Po ashtu, dokumentohet vendimi i datës 29.12.1947, me të cilin Et’hem Haxhiademi dënohet me vdekje, ndërsa pjesa tjetër e të akuzuarve dënohet me burgim. Në vijim, në dosje gjendet kërkesa për falje e paraqitur nga Et’hem Haxhiademi drejtuar Presidiumit të Kuvendit Popullor, ku ai argumenton situatën e tij familjare dhe ekzistencën e fëmijëve të mitur, si dhe kërkesa e bashkëshortes së tij, Burbuqe Haxhiademi, për zëvendësimin e dënimit me vdekje me privim lirie. Materiali plotësohet edhe me një prememorie të përfshirë në dosje.

MEDIA #1

Letër ndalimi

MEDIA FAQE #1



QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNISË
GJYKATA PROKURORIA PUBLIKE GYTETIT
ELBASAN

Nr. i Dosjes 2

1911

Letër-ndalim i 1) Përhershëm

2) [redacted] Unë Josif T[illegible] Prokuror P.Qytetit

Tue qënë se ET'HEM HAXHIADEMI, bir i Emit

dhe i Alemshasë vjeç 445 nga Elbasan me mjeshtëri Nëpunës

me shënjat trupore të veçanta që pasojnë: –

pandehet për deliktin e anmik i Popullit të kryer më –

dhe të parashikuar prej nenit 3 Nr.1 të ligjës Nr.372 dt. 12/XII/1947.

Tue parë dhe nenin –

u r d h ë r o n

ndalimin e tij për 3) Përhershëm dhe mbylljen e tij në burgun e anmiqve të Popullit Çdo fuqi e armatosun ngarkohet me eksekutimin e këtij urdhëni.

Elbasan më 7 të muajit Janar të vjetit 1947.

Prokurori i Republik
(Josif [illegible])

1) Përhershëm ose përkohshëm. 2) Autoriteti gjyqësor që urdhëron ndalimin. 3) Një kohë të pacaktuëme ose përkohëshisht.

AIDSSH

Letër ndalimi

INFORMACION

Letër ndalimi

DOSJA	1565-A
NR. I FLETEVE	203
GJUHA	shqip
DATA E KRIJIMIT	1958
LLOJI I DOKUMENTIT	Hetimor-Gjyqësor


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Urdhëresë paraburgimi

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
Prokurortja Publike e Qytetit Elbasanit
Sektori i Sigurimit
Nr. i Aktit 3
Nr. Prot.

27/1

URDHËNESË PARABURGIMI

Sot me 9 të muajit Dhetuer të vitit 1947 në Prokurorin Publik të Qytetit, Unë Josif Taja Prok.Publik i ngarkuar me hetimet, pasi shqyrtuam çeshtjen që i përket të pandehun Et'hem Haxhiademi, nga Elbasani

që akuzohet se me xxxx për vepra tradhtari kundra Pushtetit.-

duke marë parasysh se nga provat e deritashme që janë të mjaftueshme

bëhet e besueshme akuza që rëndon mbi të pandehurit në fjalë, duke marë parasysh se ekzistojnë kushtet e gërmës a. të nenit 9 të urdhënesës Pr. Përgjithëshme Nr. 2 dt. 1-XI-946,

duke marë parasysh se vepra parashikohet si faj prej nenit 3 Nr.1 të ligjes Nr.372 dt. 12/XII/1947. dhe pas-ejell një dënim që kalon në maximum -

në bazë të paragrafit - të nenit 10 po të asaj urdhënese

URDHËNOJMË

Paraburgimin e të pandehurit Et'hem Haxhiademi dhe shoqërimin e tij në burgun e arrestuve të Popullit

Kopja e kësaj urdhënese bashkë me letër-rrethtimin dorëzohet të pandehurit i cili ka të drejtë kundërshtimi brenda tri ditëve nga e ncsërmja e njoftimit, pranë Prokurorit Publik më të lartë.

PROKURORI PUBLIK
(Josif Taja)

M' u dorëzua kopja e kësaj urdhënese me fjalë letër-rrethtimin sot me datë 9/XII/47

NJOFTUESI: (Demir Gjoka)

I PANDEHURI: (Et'hem Haxhiademi)

Urdhëresë paraburgimi

INFORMACION

Urdhëresë paraburgimi

DATA E KRIJIMIT	1947
	203
GJUHA	shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Hetimor-Gjyqësor


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Vendimi me vdekje

MEDIA FAQE #1



Faqe Nr.XII-te

Prokureri kerkoj aktet per shqyrtim
V e n d i m

Per shqyrtimin e akteve nga ana e prokurorit dita e gjygit u la perme datem 27.XII.1947 ora 3 mbas dite
Elbasan,me 26.XII.1947

Sekretari Antari Antari K r y e t a r i


Ditem e orem e caktuem gjygi u fermue si me pare
U suellen te pandehurit nga burgu dhe mbasi u vuen ne vendin e caktuem filloj gjygi betimisht
Prokureri kendoj pretencen dhe kerkoj denimin e te pandehurve si vijon:Et-hem Haxhideni,Abdulla Mema,Met Gjata,Abdyl Kongoli me privim lirije per jete,Veniamin Haxhi shkev.,Reshat K.,Khavit B.,Ibrahim Fleshti me nga 20 vjet privim lirije per te dekyrshme,Spiro Bardhi, Halit Imaja dhe Ahmet Herbelli me nga 15 vjet privim lirije pune te detyrueshme dhe u bashkue me aktet
U mbeten me pyetje te [illegible] per fjalen e fundit dhe thane:
Et-hem Haxhideni tha:Nuk jam fajtore kerkoj pafajsine.
Abdulla Mema tha:Ne meshiren e Trupit gjykues.
Met Gjata tha:Ne meshiren e Trupit gjykues nuk kam marre pjese ne mbonji organizate.
Abdyl Kongoli tha:Kerkoj meshire nga Trupi gjykues.
Veniamin Haxhi-shkev. tha:Kam besim ne mbrojtjen e te mbrohemve gjykate dhe te me meshireje se jam i ri.
Reshat Karamani tha:Me meshiren e Trupit gjykues
Khavit Bajraktari tha:Me meshiren e Drejtesise.
Ibrahim Fleshti tha:Me meshiren e Trupit gjykues.
Spiro Bardhi tha:Me meshiren e Trupit gjykues
Halit Imaja tha:Kam besim ne drejtesi.
Ahmet Herbelli tha:Jam krejt i pafajshem dhe kerkoj lirimin tim nga burgu dhe meshire nga gjyqi i popullit.-
V e n d i m
Per shqyrtimin e akteve nga ana e Trupit gjykues dita e gjygit u la perme datem 29.XII.1947 ora 20 te mbremjes
Elbasan,me 27.XII.1947

Sekretari Antari Antari K r y e t a r i

Ditem e orem e caktuem gjygi u fermue si me pare
U suellen te pandehurit nga burgu dhe mbasi u vuen ne vendin e caktuem filloj gjygi
Mbasi u shqyrtuem aktet nuk sbeti gja tjeter gjygit ju dha funt dhe u deklarue ky:
V e n d i m
N'emen te Popullit Shqiptar
Gjykata Ushtarake Elbasan e fermue proj:
Kapiten I-re Myftar Grabocka Kryetar

Vendimi me vdekje

MEDIA FAQE #2



Faqe Nr.XIII-te

Toger Qemil Kusarej Antar
Toger Tase Dhame Antar

I asistuar nga sekretari Kapter Ahmet Hyskmeri,tue gjem gati dhe prokureri Kapiten Kristo Kushi dhe.

Sot me date 29.XII.1947 u mbleth perte gjykuem te pandehurit dhe dha kete vendim.

V e n d i m

Prokurerija Ushtarake me akt-akuzen e saj date 18.XII 1947 i ka sjelle per gjykim kesaj gjykate me bane te ligjes mbi fajet penale kundra Popullit dhe Shtetit te pandehurit e rreshtuar.-

1)-Et-hem Haxhideni i biri i Ismit dhe i Alemshes, vjeç 45 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon perfesor,i martuar me femije me arsim te larte,i pa denuar.

2)-Abdulla Mema i biri i Shliut dhe i Rabijes,vjeç 52 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon Kafexhi,i martuar me femije,pa arsim (lim me shkrue dhe kendue)i pa denuar,

3)-Mehmet Gjata i biri i Aliut dhe i Banes,vjeç 34 lin dur dhe banues ne Elbasan,me profesjon kafexhi,i pa martuar,me arsim te mesem i pa denuar.

4)-Abdyl Kongoli i biri i Aliut dhe i Hasibes,vjeç 58 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon ish drejtor i Fabrikes S.I.D.E.,i mar tuar me femije,me arsim te larte,i pa denuar.

5)-Veniamin Haxhiykevi i biri i Jam,it dhe i Eftasis vjeç 30 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon avokat,i martuar me femije , me arsim te mesem i pa denuar.

6)-Reshat Karamani i biri i Karamanit dhe i Shefqete e vjeç 45,lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon ish Nenepunes,i martuar me femije,me arsim te mesem,i pa denuar,i paraburgosum me 47 dite burge per faje politike.

7)-Khavit Bajraktari i biri i Fuatit dhe i Nerves,vjeç 58 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon prenar,i martuar me femije,me arsim te mesem i pa denuar.

8)-Ibrahim Fleshti i biri i Isufit dhe i Sabires,vjeç 50,lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon tregtar,i martuar me femije,me arsi terpisht,i pa denuar.

9)-Halit Imaja i biri i Aliut dhe i Hajrijes,vjeç 36 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon shofer,i pa martuar,pa arsim(lim me shkrue dhe me kendue)i pa denuar.

10)-Ahmet Herbelli i biri i Khaferrit dhe i Khadijes, vjeç 50 lindur dhe banues ne Elbasan,me profesjon tregtar dhe mekanik,i martuar me femije,me arsim fillor,i pa denuar.

11)-Spiro Bardhi i biri i Konstantinit dhe i Merijes, vjeç 37 lindur dhe banues ne Tirane,me profesjon bujke, i martuar,me femije,me arsim fillor i pa denuar.


Per sikim se:

a)-gjithe te pandehurit jane inkriminuar dhe bashkpunuar te nji organizate klandestine ne Elbasan kundra Pushtetit Popullor.

b)-Jane marre me nxjerrje propaganda te sabotejne Reformen te kriejne disfatizem dhe pa siguri.

Vendimi me vdekje

MEDIA FAQE #3



Faqe Nr.XIV.-te

c)-Kane krijuar lidhje me krisimchat e luftes me armati si ne Alush Lleshanakun e te tjere dhe jane perpjekur me cdo ayyre per organizimin e tyre,nga ana tjeter dyke qene te mbeshtetur me nji mderhyrje Anglo-Amerikane jane perpjekur te pregatisnin nji kryengritje kundra Republikes Popullore te Shqiperis.

ç)-Kane axitur tarradisurit te kryejne aksjone dhe te vrasin agjerit e Pushtetit.-

d)-Kane sabotuar aggedhjet e Dy Dhjeterit

e)-Kane pase lidhje te ngushta me organizatat terroriste me Tirane si me armiqt e Popullit Abdyl Kokoshi,Selaudin Tete e te tjere prej te cileve kane marre udhezime here pas here dhe njikohesisht u kane dhene informata rreth aktivitetit te tyre.

G J Y K A T A

Mbasi shqyrtoj proçes verbalet e mbajtura kundra te pandehurve nga organet e sigurimit te Shtetit.

Mbasi shqyrtoj proçes verbalet e mbajtura nga prokurorija

Mbasi mbajti apellacion e te pandehurve

Mbasi mbajti pretencen e prokurorit,i cili kerkoj fajtorin e te gjigje te pandehurve dhe deninin Ll:Et-hem Harkllademi,Abdulla Memo dhe Met Ujates me Vdekje;te Abdyl Kongoli me burgim te perjetshem,te Vendimin Harkllajkovit,Reshat Karamemit,Khavit Biyaku dhe Turkan Fleshtit me nga 20 vjet burgim Spire Bardhit,Ahmet Hezhollit dhe Halit Lamçe me nga 15 vjet burgim.

Mbasi mbajti fjalen e fundit e te pandehurve,te cilet pjeserisht kerkuan lehtesimin e fajit.

K o n s t a t o n

Te pandehurit Ll:Et-hem Harkllademi dhe Abdulla Memo,dyke qene kon-sekuentat ne politiken e tyre armiqesore kundra Popullit gjate kohes shkaterrimit, pas shkrirjit te Shqiperis qene imisjatore per rierganizimin e grupeve kladestine me qellim e Elbasanit dhe aktivizohen perte gjetur elementa te tjere kundershtare te Pushtetit si Ballore,Ajellare,Pseudo-Intelektuale,tregtar te pasur dhe me maj 1945 formojne organizaten ilegale dhe terroriste te ballit me kete kemitet Qarkor:

1)-Et-hem Harkllademi Kryetar,2)-Abdulla Memo,Zija Lumiku,Ferit Hysen Bagadi dhe Shefki Mherelli anetare,te cilet si mbas udhezimeve te marra nga Qendrezi Tiranes kane marre kete vendim:

1)-Te formohen N/Komitete me rrethe,te gjerohin organizaten me elementa te pakenaqur me pseudo-Intelektuale me elementa te prekur Nga Refer mat e mbrymes te Pushtetit.-

2)-Te lidhen me tarratisurit krimunela lufte si me Alush Lleshanakun e te tjere,ti ndihmonin dhe ti organizonin keta perte kryer aksjone dhe atentate kundra kjorseve te Pushtetit.

3)-Te sabotonin aggedhjet e dy Dhjeterit me ayyre t'organizuar

4)-Te axhitonin neer elementa te pakenaqur sidomos me Ballore, Pseudo-Intelektuale dhe kulak ishati perti bedhur me armati me qellim qe te shtonin rradhet e bandave t'armatosura.-


5)-Te mbanin lidhje te ngushta me komitetin Qarkor dyke i dhe me informata rreth aktivitetit te tyre dhe te merrain here pas here udhezime.

6)-Te Sabotonin punen ne cdo sektor dhe te shkaterronin ekonomine e vendit.

7)-Perfundimisht te arrinin me nji kryengritje t'armatosur

Vendimi me vdekje

MEDIA FAQE #4



Faqe Nr.XVI-te

te prokur dhe kundershtare te Pushtetit,aktivitet e ka shvillluar deri me ditem e arrestimit.

Te pandehurit ne pergjithesi,me anen e axhitasjonit dhe propagandes kane sabotuar ligjet dhe Reformat e Pushtetit,kane pershapur perrallen se:Anglo-Amerikanet do te zbarkojne,Nemanke-Fashistet dyke do te sulmojne, pa evitueshmenine e nji lufte te trete bothore e te tjera,me qellim qe te krijonin panik dhe pasiguri ne Pushtetine tone Popullor;pa kenbinim me tarratisurit krimunela lufte Alush Lleshanakun e te tjere kane kercenuar popullin dhe kane bere krime kundra elementave te Frontit si ne katundin Murriqan e gjetke.

Perfundimisht qellimi i kesaj organizate terroriste ka qene te arrinin me rrezikim e Pushtetit Popullor me violence dhe ta benin vendin tone fushe per ndermarjen e te huajve.

Me gjithse nji pjese e te pandehurve para gjyqit u munduan te mbajne akuzen,per gjykata dyke marre parasysh atribuimet qe te pandehurit e tjere i bejne ajeri tjetrit,si dhe deponimet e gjate t'armiqve te Popullit Zija Lumiku e shuke te gjykuar nga kjo gjykate,te cilet kane deponuar kjarte gjithe veprimtarine e kesaj organizate me bashkpunim te te pandehurit,si dhe deponimet e vete te pandehurve direkte dhe indirekte te bera si para gjyqit asht dhe ne proçes verbalet e mbajtura para organeve te sigurimit te Shtetit dhe prokuroris Publike.

Bajo bindje te plote se t[illegible]ithe pandehurit jane fajtore dhe vepren e tyre kriminela e kane kryer me keqdashje.

Prandaj Trupi gjykues dyke dashur pjesrisht kerkimin e prokurorit dhe ne baze te Nenave 2"3 Nr.1,2,5,7, te Nenit 6 te ligjes me Nr.372 date 12 Dhjeter 1946 mbi fajet penale kunder Popullit dhe Shtetit,dekllaron fajtore te gjithe te pandehurit dhe sipas Nenit 4 paragrafit I-re te ligjes siperme.

V e n d o s i

Ndeshkimin e kyre me vijen:1)-Et-hem Harkllademit,Abdulla Mema me Vdekje,humbjen e perhershme te drejtave Politike e civile.

Mehmet [illegible],Abdyl Kongoli me privim lirije per jete dhe humbjen e te drejtave Politike e civile per cdo kohe dhe pune te detyruar.

Vendimin Harkllajkovi,Khavit Biyaku dhe Reshat Karamani me nga 20 vjet privim lirije pune te detyrushme si dhe humbjen e te drejtave Politike e civile per 5 vjet kohe sejcilit.

Ahmet Hezhollit,Ibrahim Fleshtit,Halit Lamçe dhe Spire Bardhit me nga 15 vjet privim lirije pune te detyrushme si dhe humbjen e te drejtave Politike e civile per 5 vjet kohe sejcilit.

Per te gjithe te pandehurit konfiskimin e pasuris se tyre si mbas inventarit te ndodhen ne dosjer.

Aktet e te denuarve me Vdekje i dergohen gjykates Ushtarake per shqyrtim dhe aprovim,ndersa perte pandehurit e tjeter akti i kundershtu eshte mbrenda 8 ditesh nga data e dekllarimit.

Te pandehurve i njoftohen shpenzimet gjykate lek 54

Elbasan,me 20.XII.1947

Sekretari Anetari Anetari Kryetari

Vendimi me vdekje

INFORMACION

Vendimi me vdekje

DATA E KRIJIMIT	1947
NR. I FLETEVE	203
GJUHA	shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Hetimor-Gjyqësor


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Lutje për falje e Et’hem Haxhiademit

MEDIA FAQE #1



ZYRË AVOKATORE
Pg. FUAD ASLLANI
ELBASAN
Nr.Rend.70
Gratis

Vdekje Fanizmit - Liri Popullit

Me anen e Gjykates Ushtarake te Elbasanit, 38.

PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR,

T I R A N E .

LUTJA PER FALJE E TE DENUARIT ME VDEKJE ET'HEM HAXHIADEMI

Nr 11 Prot.
Lotë 13.1.948.

Zoti Kryetar,

Me Vendimin e shpallur me .12.1947 te Gjykates Ushtarake te Elbasanit, ne baze te nenit 4 paragrafi I te Ligjes Nr.278 mbi Fajet Penale kundra Popullit dhe Shtetit, jam denuar me ndeshkim kapital.

Fajet qe me kane qene atribuara u-faktuan plotesisht - gjate procedimit te gjyqit, dhe pa dyshim per fajtorine t'ime te rende, me perket edhe ndeshkim i rende.

Jam ati i nji familjeje me pese çiliminj, qe te vetmen meshtetje me kane pasur mua.

Ne kete çastin suprem te jetes s'ime, plot pendim per gjithe fajet e mija, ju bej nje apel qe te meshironi per te 5 femijt e mij dhe te m'a falni jeten t'ime, duke e kembyer denimin e vdekjes ne ndeshkim me privim lirije.

Me shprese se kejo lutja e ime mund te mirret ne konsiderim, nenshkruhem,

Elbasan, me 8.1.1948.

Me nderime shume te larta,
I denuari me ndeshkim kapital,
Et'hem Haxhiademi.

Et'hem Haxhiademi

ARSH

Lutje për falje e Et’hem Haxhiademit

INFORMACION

Lutje për falje e Et’hem Haxhiademit


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Lutje për falje nga bashkëshortja e Et’hem Haxhiademi

MEDIA FAQE #1



Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

39

Nr.Rend. 71
Grati

Me anen e Gjykates Ushtarake te Elbasanit,

PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR,

T I R A N E .

Lutja e Burbuqe Haxhiademit, bashk-shortja e te denuarit me vdekje Et'hem Haxhiademit, per faljen e nieshkimit te te shoqit te saj.

Zoti Kryetar,

Me Vendimin e shpallur me .10.1947 te Gjykates Ushtareke te Elbasanit, im shoq Et'hem Haxhiademi esht denuar me vdekje per fajet qe ka kryer kundra Popullit dhe Shtetit.

Im shoq Et'hem Haxhiademi ne rrjedhe e tij esht munduar t'u sjelle nionje shperbim atdheut dhe Popullit. Perse esht fajtor ne zgjedhjen e vijes politike te tij, vije kejo qe esht dellkt i rende dhe krim kundra interesave te lartа te Pushtetit. Dhe, pra mbasi fajesia e tij esht faktuar, me arsye esht gjykuar dhe denuar prej Gjykatoves Ushtarake te ketushme.

I denuari me vdekje Et'hem Haxhiademi esht atë i pese femijve te mitur, qe te vetmen meshtetje e kane pasur kete ate te tyre. Prandaj, si bashk-shortja e tij, eshe ne emer te ketyre pese femijve qe mbeten bonjake, ju kej nje kjel te drekshem qe te meshironi dhe te dekretoni faljen e jetes se tij, duke e kthyer nieshkimin kapital ne denim me privim lirije, qofte eshe te perjeteshme.

Me shperese se kejo lutja e ime, e nji nane te zhuritur qe mbetet me pese femije te mitur te desperuar, ju te mirret ne konsiderim, nenshkruhem,

Me nderime shume te larta
Bashkshortja e te denuarit me vdekje Et'hem Haxhiademi.

Elbasan, me 8.1.1948.

Burbuqe Haxhiademi

Lutje për falje nga bashkëshortja e Et’hem Haxhiademi

INFORMACION

Lutje për falje nga bashkëshortja e Et’hem Haxhiademi


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Prememorie

MEDIA FAQE #1



- P R E M E M O R J E -

18

Ipandehuni Et'hem Hambiudemi rrjeth prej nji shtrese të pamun qytetare.Ka qenun besnik i Ahmet Zogut dhe për besnikëtin ka ndej thuejse për gjithë kohën në Tiranë pranë Ministris P.Mbrendeshëne.

Me organizimin e Organizatës së Ballit n'Elbasan bahet Antar i Qarkorit të Ballit t'Elbasanit dhe ish rëndrmjetës pranë Komitetit Qendror.Gjatë dy operacioneve ka qenun në Tiranë pranë Ministris P.Mbrendeshëne,ishte antar Qarkori.

Me plotimin e Shqipnisë n'rior organizimin e Ballit,bahet prap antar i Qarkorit Ballit t'Elbasanit dhe ma sqetsin,veprat e tija,besimin që gëzonte nga Qendrori i Ballit bahet Kryetar i Qarkorit të Ballit,t'Elbasanit.

Ka dhanun gjithë [illegible] do të ndiqte kjo Organizatë n'Elbasan,ka provokue mbledhje,ka dhanun udhëzimet t'arrestimeve se si të veproninë ka ngritun grupe e armatarve dhe profesorave dhe i ka organizue këto n'organizatën e Ballit.

Për të gjitha të shqyrtuet mendojmë të goditet rendë,mbasi veprat e tija i ka [illegible] rëndë.-

Elbasan,më 10/XII/1947.

PROKUROR PUBLIK
(Josif Daja)

AIDSSH

Prememorie

INFORMACION

Prememorie

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.